



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 3262/1 Prot.

Tiranë, më 18.05.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1410/2, datë 01.09.2009.

**SHOQËRISË “EDITI-A” SH.P.K
Fshati Kepelek, Tropojë.**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “EDITI-A” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1410/2, datë 01.09.2009, për mineralin Krom, në Objektin “Lajthizë Përrua”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, me shkresën Nr.861, datë 14.04.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.3262, Prot, datë 19.04.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1410/2, datë 01.09.2009, për mineralin Krom, në objektin “Lajthizë Përrua”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, pasi u analizuan shkaqet e aksidentit më datë 19.03.2022, u konstatua se aksidenti ka ndodhur si pasojë e mungesës së disiplinës teknike dhe shkeljes së rregullave të Sigurimit Teknik. Referuar VKM 294 datë 10/05/2019, konkretisht janë shkelur :

Pika 2.4.2 Vendet e punës përcaktohen e zhvillohen në zbatim të projektit teknik, programit vjetor të zhvillimit të punimeve, të sigurisë për mbrojtjen nga rreziqet dhe përcaktimit kohor të kryerjes së operacioneve dhe proceseve për realizimin e punës. (Punohet jashtë programit vjetor të miratuar dhe vendi ku ka ndodhur aksidenti ka qenë jashtë programit të miratuar të punës)

Pika 2.7.5 Urdhrat dhe udhëzimet teknike për punë në zhvillimin e punimeve, pavarësisht nga regjimi i punës, duhet të lëshohen:

a) çdo ditë në veprimtaritë që kryejnë punime nëntokësore;

Propozimi i Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “dh” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1410/2, datë 01.09.2009, për mineralin Krom, në Objektivin “Lajthizë Përrua”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, që shoqëria Juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1410/2, datë 01.09.2009, për mineralin Krom, në Objektivin “Lajthizë Përrua”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

